



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2022:008297

Datë: 18.04.2023

Numri i dokumentit: 04198023

PPP.nr.01/2022

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Dega në Kaçanik, si gjykatë përbarimore e shkallës së parë, gjyqtari Riza Livoreka, si gjyqtar përbarues, duke vepruar sipas lëndës së përbarimit të Kreditorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sha (KESco), me seli në Prishtinë, me nr. i regjistrimit ..., numër i TVSH-së, kundër Debitorit S. Sh....K. nga fshati ...-Kaçaniku, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, jashtë seancë gjyqësore më datë 18.04.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. HEDHET poshtë prapësimi i Debitorit S. Sh... K. nga fshati ...-Kaçaniku, i ushtruar më datë 10.04.2021, kundër Urdhrit mbi lejimin e përbarimit P.nr.742/2021, të datës 10.01.2022, të përbaruesit privat Sh.H... L., me seli në Kaçanik, SI I PASAFATSHËM.

II. DETYROHET, debitori qe kreditorit ta ia paguaj shumën si në propozimin për përbarim, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore, të cilat do të llogariten nga përbaruesi privat, këto pagesa do ta bëhen në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Kreditori Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sha (KEco), me seli në Prishtinë, më datë 03.12.2021, në zyrën e përmbaruesit privat Sh. H L., me seli në Kaçanik, ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit Debitorit S. Sh.... K. nga fshati Kaçanik i Vjetër,

Me këtë propozim ka kërkuar nga përmbaruesi që të lejohet përmbarimi dhe të obligohet debitori që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi t'ia paguaj kreditorit borxhin në shumë prej 3,681,04€, për shkak të mos pagesës së energjisë elektrike, për periudhën kohore prej datës 26.01.2015 e deri me datën 09.11.2021.

Këtë shumë e ka kërkuar me kamatë prej 8 %, duke filluar nga dita e kalimit të afatit për pagesë e deri në pagesën definitive të borxhit si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Përmbaruesi privat më datë 06.12.2021, e ka nxjerrë urdhrin P.nr.1742/2021, me të cilin e ka lejuar ekzekutimin, po ashtu me këtë urdhër e ka udhëzuar debitorin që në afat prej 7 ditëve mundë të paraqes prapësim kundër urdhrin për përmbarim.

Përmbarusi privat një kopje të propozimit për përmbarim, së bashku me urdhërin për lejimin e ekzekutimit, i'a ka dorëzuar debitorit me daton 24.12.2021. Debitori më datë 10.01.2022, ndaj urdhrin përmbarues ka paraqitur prapësim me të cilin i ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit dhe të anulohet Urdhri P.nr.1742/2021, i datës 10.02.2022.

Po ashtu ka theksuar se propozimi për përmbarim nuk i përmban elementet qenësore që duhet ti mbajë një dokument një dokument i besueshëm përmbarimor siqë është paraparë me neni 40 të LPP-së, Tutje ka theksuar se pagimi i energjisë elektrike kërkohet prej vitit 2015-2021, e në bazë të nenit 360 1,1 të LMD-së, është parashkruar. Me këtë dispozitë parashihet se kërkesat e tilla parashkruhen pas një viti, kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, termike, gazit , ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen dhe pastërtisë etj.

Përmbauesi privat me datën 10.01.2022, një kopje të prapësimit ja ka dorëzuar kreditorit, i cili në afatin e paraparë ligjorë, ka paraqitur përgjigj në prapësim, me të cilën i ka propozuar gjykatës që prapësimi i debitorit të refuzohet.

Po ashtu ka theksuar se borxhi i kërkuar me propozim nuk është parashkruar sepse debitori për periudha të caktuara kohore e ka paguar energjinë e shpenzuar dhe e ka zvogëluar borxhin, por asnjëherë nuk e ka paguar borxhin në tersi, por me pagesat e kohë pas kohshme, e ka ndërprerë parashkrimin në kuptim të nenit 368 1 dhe 2 të LMD-së. Nga këto baza i ka propozuar gjykatës që prapësimi të refuzohet.

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, prapësimit të debitorit, përgjigjes në prapësim, ka gjetur se prapësimi i debitorit është i pasë afatshëm. Përmbauesi privat propozimin me prova dhe urdhrin për lejimin e pambarimit, debitorit ja ka dorëzuar me datën 24.12.2021, këtë fakt gjykata e ka vërtetuar nga fletë dorëzimi i cili gjinden në shkresat e lëndë, nga e cili fetë dorëzim vërtetohet se debitorit propozimi me prova e ka pranuar me datën 24.12.2021.

Gjykata ka gjetur se debitori propozimin me prova e ka pranuar me datën 24.12.2021, ndërsa prapësimin kundër urdhrin përmbaues P.nr.742/2021, të datës 06.12.2021, tek përmbauesi privat e ka dorëzuar me datën 10.01.2022, pra pas afatit të paraparë me ligje.

Me nenin 70 të LPP-së, përcaktohet se “Prapësimi duhet ti paraqitet Gjykatës brenda shtatë ditëve, pas pranimit të vendimit përmbaues ose urdhrin përmbaues “. Në rastin konkret debitori propozimin me prova dhe urdhrin përmbaues e ka pranuar me datën 24.12.2021, ndërsa prapësimin e ka paraqitur tek përmbauesi me datën 10.01.2022, pra e ka paraqitur pasi kanë kaluar 10 ditë.

Gjykata vlerësoi se kreditori propozimin për përmbaues, e ka bazuar në dokumente të besueshme konform nenit 29 par.1 pika 1.2 të LPP-së

Gjykata i analizoi pretendimet Kreditori të paraqitura me propozim për përmbaues dhe në përgjigje në prapësim dhe të njëjtave ua fali besimin për shkak se ishin të drejta dhe të ligjshme për të gjitha arsyet e cekura më lartë.

Gjykata nuk i analizoi pretendimet e debitorit të paraqitura me prapësim, sepse debitori prapësimin e ka paraqitur pas kalimit të afatit të paraparë me ligj, siç është parapara me neni 70 të LPP-së.

Nga sa u theksua më lart dhe duke u mbështetur në neni 29.par 1 pika 1.3 lidhur me neni 77 par 1 dhe 5 të LPP-së vendosi si në disozitiv të këtij aktvendimi,

Gjykata e detyroi debitorin që kreditorit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës përmbareme të cilat do të llogariten nga përmbaruesi privat sipas udhëzimit administrativ dhe duke u bazuar në nenin 13 të LPP-së

GJYKATA THEMELORE Në FERIZAJ

Dega në Kaçanik

PPP.nr.01/2022 të datë 14.04.2023

Gjyqtari,
Riza LIVOREKA

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi, është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit, ankesa i paraqitet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate, në kopje të mjaftueshme.

Ekspeduar me datën 18.04.2022

Kreditorit 1x1

Debitorit 1x1